



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	ARPL
Nr. i Faqeve Nr. Stranica	- 02 -
Nr. i Prot. Prot. No.	5564-2/23
Datë Date	28-06-25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stahog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	26.12.2024
REFERENC-Ë:	5564/23 - ZSP- 2024
PËR/ZA/TO:	„New Co Ferronikeli Complex L.L.C” , Rr Besim Mala , nr 227, Gillogoc
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së; Z. Agron SHALA, U.D, Drejtor i ARPL-së; Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investiv, për shfrytëzim të ujit, me Nr. të protokollit: 5564/23, parashtruar nga „New Co Ferronikeli Complex L.L.C” Sh.p.k. dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

LU

Datë: 26.12.2024

Sekretari i Përgjithshëm, i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës dhe nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurat e Përgjithshme Administrative, si dhe dispozitave ligjore të U.A. MMPH- Nr. 03/2018 Për procedurat për Leje Ujore, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës, me nr. protokoli 5564/23, datë 25.09.2023, „New Co Ferronikeli Complex L.L.C” Sh.p.k. K. Glllogoc për shfrytëzimin e ujit industrial, për ftohje, nga Kanali i Iber Lepencit.

1. Sasia shfrytëzuese e ujit për procesin teknologjik, në pikën me koordinata (X=7 491 853.58; Y= 4 723 171.45,) në Kanalin e ujitjes të “Iber Lepencit” sipas projektit - dokumentacionit tekniko investiv, si dhe bazuar në sasinë orientuese vjetore të planifikuar nga “Iber Lepenci” për Ferronikelin është 1,706.006.0 m³/Vit;
2. Sasia e shfrytëzimit të ujit duhet të jet bazuar në sasinë orientuese, të paraparë nga “Iber Lepenci” ;
3. Tarifa e shfrytëzimit të ujit për procesin teknologjik, pastrimin dhe ftohjen e makinerisë, duhet llogaruar për pagesë bazuar në sasinë orientuese të planifikuar nga “Iber Lepenci”;
4. Pala nëse vendos për ndryshim të furnizimit duhet të aplikoj në ARPE për ndryshim të këtij vendimi;

Faqe 2 nga 4



5. Pala obligohet përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m³/ditë), dhe sasinë vjetore (m³/vit) të regjistruar nga njehsori i vendosur në pikat e marrjes;
6. Për sasitë e shfrytëzuara pala obligohet, që për çdo vit, sipas U.A për strukturën e pagesave të ujit, të informoi me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;
7. Nr. Serik i ujëmatësit për kyçjen, duhet prezantuar në ARPL/MMPHI, brënda 15 dite dhe të i njëjti nuk mund të ndryshohet, për ndërrimin e mundshëm të tijë duhet informuar Organi përgjegjës që e ka lëshuar këtë vendim, gjithashtu vendosja e tijë duhet të jetë në përputhshmëri me U.A për strukturën e pagesave të ujit në fuqi;
8. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
9. Për këtë pala obligohet të raportoj shfrytëzimin, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
10. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
11. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit, të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
12. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
13. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
14. Validiteti i Lejes Ujore pushon, në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: "Elaborati dhe dokumentacioni Tekniko - Investiv për leje ujore për shfrytëz të ujit nga kanali i ujitjes "Iber Lepenc" për nevoja të procesit teknologjik nga kompania " New Co Ferronikeli L.L.C." Gllogoc. Certifikata e Biznesit (810507444) të kompanisë New Co Ferronikeli Complex L.L.C. Leja Mjedisore e Integruar "New Co Ferronikeli Complex" L.L.C. Fab per prodhimi e Ferronikelit Nr 12/593/102/zsp-237/14, datë 30.10.2014; , Vendimi për pëlqim mjedisor lidhur me projektin e e VNM-së-së për shkritoren e New Co Ferronikeli Complex Nr :07/1403/1- ZSP- 1488, datë 13.07.2007; Marrëveshjen e kontratës, me K.R.U. "Prishtina", datë 23.07.2007; Amandamentimi i kontratës datë 16.05.2013; Anex nr. 2 i



marrëveshjes (070719), me K. Ujësjiellësi Rajonal sh.a. për Qiranë; Kontratë në mes të “New Co Ferronikeli Complex L.L.C.” kontrata e shitblerjes së ujit të papërpunuar Për “New Co Ferronikeli,

Andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, bazuar në shikimin në vend, datë 19.01.2024, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në trashigimin blerëse të objektit të vjetër që nga paraluftra ne Kosovë

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në inicimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 5564/23 - ZSP- 2024, datë: 26.12.2024

Prishtinë

T’i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Gllogoc;
- Arkivit të Ministrisë.

U.D. Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së;



Izedin BYTYQI